

VENDIM
Nr. 764, datë 2.11.2016

PËR NXJERRJEN NË SHITJE TË DISA MJETEVE TË TRANSPORTIT TË RËNDË, TË GRUPIT A, TË KALUARA NË FAVOR TË SHTETIT SI PASOJË E KONFISKIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 10, të ligjit nr. 9900, datë 10.4.2008, "Për rezervat materiale të shtetit", me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit (DPRMSH) për të realizuar shitjen me ankand publik të mjeteve të transportit të rëndë, që plotësojnë kushtet për qarkullim, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. DPRMSH-ja, për llogaritjen e vlerës së mjetit të transportit që plotëson kushtet për qarkullim, i cili do të dalë në ankand, sipas pikës 1 të këtij vendimi, do t'i referohet tabelës së dërguar nga zyra doganore, e cila ka përdorur si burim informacioni buletinet që pasqyrojnë çmimet e shitjes në tregjet evropiane. Vlerës së gjendur në tabelë i zbritet 50%, si koeficient amortizimi, për shkak të përdorimit të mjetit në territorin e Republikës së Shqipërisë. Vlera e mbetur është vlera e mjetit të transportit, e cila do të jetë edhe vlera fillestare e ankandit.

3. Për mjetet e kategorizuara për qarkullim, të cilat nuk janë shitur pasi u janë nënshtruar procedurave të shitjes me ankand publik për tre herë me radhë, DPRMSH-ja vijon me procedurat e trajtimit për skrap dhe njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Transportit Rrugor për heqjen nga qarkullimi dhe çregjistrimin e këtyre mjeteve.

4. DPRMSH-ja lejohet të realizojë shitjen me ankand publik të mjeteve të transportit të rëndë që nuk plotësojnë kushtet për qarkullim, të destinuara për t'i trajtuar si skrap, sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. DPRMSH-ja, për llogaritjen e vlerës fillestare monetare të ankandit, sipas pikës 4 të këtij vendimi, do të bazohet në mesataren e çmimit për kategoritë përkatëse të skrapit, sipas të dhënave të dërguara nga zyra doganore më e afërt.

6. Të ardhurat e përfituara nga shitjet me ankand derdhen në buxhetin e shtetit.

7. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

Lidhja nr.1**LISTA E MJETEVE TË TRANSPORTIT TË RËNDË QË PLOTËSOJNË KUSHTET PËR QARKULLIM**

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Ngjyra	Viti i prodhimit	Lloji i karburantit	Fuqia motorike
1	Kokë trajleri Scania	FR0185C	Blu	1997	Naftë	12400 cc
2	Kamion Man	KO7078B	Blu	2002	Naftë	S'ka
3	Rimorkio trajleri frigorifer	FR 0089C	E bardhë me shirita	1997	S'ka	S'ka
4	Trailer	KO2615B	Kafe me mbulesë blu	2002	-	-

Lidhja nr. 2**LISTA E MJETEVE TË TRANSPORTIT TË RËNDË QË NUK PLOTËSOJNË KUSHTET PËR QARKULLIM DHE QË DO TË TRAJTOHEN PËR SKRAP**

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Ngjyra	Viti i prodhimit	Lloji i karburantit	Fuqia motorike
1	Rimorkio trajleri e hapur	DR 2778 C	S'ka	1986	S'ka	S'ka
2	Rimorkio trajleri Iveco e hapur	S'ka	S'ka	1990	S'ka	S'ka
3	Renault – kokë trajleri	TR 6759 H	E kuqe	1995	Naftë	12000 cc
4	Kokë trajleri Iveco	816AN971	Blu	1990	Naftë	
5	Kamion Benz	TR 8319 A	Blu	1986	Naftë	2800 cc
6	Trailer -Viberti	DR 9928 A	E bardhë	1982	-	-
7	Kokë trajleri - Scania	OF 04043	E bardhë	1988	Naftë	3200 CC
8	Trajler	OF 04030	Denat	1994	-	-
9	Kamion - Fiat	DR 4869 A	Vishnje	1987	Naftë	2800 cc
10	Trailer - Volvo	SH 8322 C	E bardhë	1987	-	-
11	Kokë traileri – M. Benz	LE 2218 A	Denat	1977	Naftë	3200 cc
12	Trailer frigorifer	TR 0306 D	Denat	1992	-	-
13	Betoniere - SAURER	TR 6266 H	Blu e hapur	1985	Naftë	S'ka

